

V E N D I M
Nr. 358, datë 28.7.1999

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE
TË DOGANAVE**

*(Ndryshuar me VKM nr. 380, datë 14.7.2000; nr. 431, datë 11.6.2001; nr. 326, datë
27.6.2002)*

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999 “Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Për punonjësit e doganave, skema e strukturës së pagës është sipas lidhjes nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

a) *Paga e drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave bëhet 71 900 lekë në muaj.*

b) *Paga e zëvendësdrejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave bëhet 53 600 lekë në muaj.*

II. Struktura e pagës mujore përbëhet:

1. Paga e grupit sipas nivelit arsimor të kërkuar nga vendi i punës:

- Paga e grupit	I	“1”	Diplomë e shkollës së lartë
- Paga e grupit	II	“2”	Diplomë mbi shkollën e mesme
- Paga e grupit	III	“3”	Diplomë e shkollës së mesme
- Paga e grupit	IV	“4”	Dëftesë lirimi (arsimi 8-vjeçar)

Diploma mbi shkollën e mesme konsiderohen të gjitha diplomat e kurseve me program mësimor të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mbështetur në legjislacionin në fuqi. Në këtë grup përfshihen, gjithashtu, të gjithë ata të cilët kanë mbaruar 2 vite akademike të shkollës së lartë.

Pagat për çdo grup pune janë sipas lidhjes nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Shtesa për vjetërsi në punë, në profil, jepet në masën 2 për qind, pas çdo viti pune deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

3. Shtesë kualifikimi. Kjo shtesë jepet sipas dëshmisë së kualifikimit individual dhe llogaritet mbi pagën e grupit në përqindje, si vijon:

- Në masën 5 për qind, për ata me dëshmi kualifikimi të shkallës së tretë.
- Në masën 10 për qind, për ata me dëshmi kualifikimi të shkallës së dytë.
- Në masën 20 për qind, për ata me dëshmi kualifikimi të shkallës së parë.

Në rastin e punonjësve të doganave kjo kolonë është bosh dhe do të plotësohet me përcaktimin e standardeve dhe niveleve të kualifikimit, në një të ardhme.

4. Shtesa e pozicionit është përcaktuar për çdo vend pune sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Shtesa për kushte pune është përcaktuar për çdo vend pune sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Deri në fund të vitit 1999, doganierët pa arsim përkatës, të zëvendësohen me

punonjës me arsim të lartë, sipas kërkesave të Kodit Doganor.

IV. Ngarkohet Ministria e Financave që, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, të nxjerrin udhëzimet përkatëse në zbatimin e këtij vendimi.

V. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 437, datë 3.9.1993 “Për pagat e punonjësve të tatimeve dhe doganave” për pjesën e punonjësve të doganave shfuqizohet.

VI. Ky vendim i shtrinë efektet financiare nga data 15 korrik 1999.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

LIDHJA NR.1
STRUKTURA E PAGËS SË DOGANAVE

(Ndryshuar me VKM nr. 380, datë 14.7.2000; nr. 431, datë 11.6.2001; nr. 326, datë 27.6.2002)

Emërtimi	Paga mujore				
	Paga individuale			Shtesa e profesionit	
Kategoria	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (në %)	Shtesa për kualifikim (në %)	Shtesa për pozicion në lekë	Shtesa për kushte pune në lekë
A Drejtor Drejtorie në Departament Drejtor Drejtorie Rajonal	1	2% e PG për çdo vit pune		26 710	14 680
B Përgjegjës Sektori Kryetar Dege Inspektor	1	2% e PG për çdo vit pune		21 170	12 760
C1 Specialist, Hetues dogane Drejtues turni	1	2% e PG për çdo vit pune		13 350	11 915
C2 Doganier	1	2% e PG për çdo vit pune		10 500	9 790
C2 Doganier	3	2% e PG për çdo vit pune		10 500	8 760
D1 Doganier, shofer, regjistruar, sekretare, magaziniar, operator, laborant	3	2% e PG për çdo vit pune		8 580	8 760
D2 Centralist. Sportelist.	3	2% e PG për çdo vit pune		8 580	8 760
Sanitar.Punëtor mirëmbajtje	4	2% e PG për çdo vit pune		4 930	2 120

LIDHJA NR.2

(Ndryshuar me VKM nr. 380, datë 14.7.2000; nr. 431, datë 11.6.2001; nr. 326, datë 27.6.2002)

Grupi	Paga në lekë
1	9 720
2	8 640
3	6 480
4	3 890